

**STATUTI  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
SKINTASTIC BEAUTY SHPK**

Sot më datë 06/05/2023, në adresën: Rruga e Kavajes, Kompleksi, "Square 21", shkalla 2, Ap. Nr.8, Tirane, u mblohen:

**Znj. Leida Rakipaj** e bija e Nendorit dhe Leonores, e datëlindjes 17/03/1984, lindur ne Fier, Shqipëri, dhe banuese në BLV "Bajram Curri", Nd. 20, H. 5, Ap. 7, Njesia Administrative Nr. 3, 1019, Tirane, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Leternjoftimit me numër 035398465, lëshuar nga Ministria e Brendshme e Republikës se Shqipërisë më datë 19/12/2019 dhe

**Znj. Migena Bego**, e bija e Zoit dhe e Lirise, e datëlindjes 02/10/1975, lindur ne Fier, Shqipëri, dhe banuese në "Kompleksi Argenta", Vishaj, Tirane, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Leternjoftimit me numër 035180755, lëshuar nga Ministria e Brendshme e Republikës se Shqipërisë më datë 25/11/2019.

Te cilet me vullnetin e tyre të plotë dhe te lirë, përmes këtij akti, themelojne një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjispcionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe sipas kushteve të përcaktuara ne këtë Statut.

**NENI 1  
THEMELIMI DHE EMERTIMI**

Personat e sipërpërmendur nëpërmjet këtij akti vendosin të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të quajtur SKINTASTIC BEAUTY Sh.P.K., (më poshtë e quajtur "Shoqëria") në përputhje me ligjin shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar (këtu e me poshtë i quajtur edhe Ligji).

**NENI 2  
PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrën Kombëtare të Biznesit, Shqipëri.

**NENI 3  
SELIA, KOHEZGJATJA DHE EMRI TREGTAR**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga : Rruga e Kavajes, Kompleksi, "Square 21", shkalla 2, Ap. Nr.8, Tirane, Shqipëri.

Shoqëria mund të hapë dhe të kryejë aktivitet në vende të tjera, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Administratori eshte përgjegjës për hapjen e njësitë dytësore te aktivitetit te shoqërisë brenda territorit te Republikës se Shqipërisë.

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

Emri tregtar i shoqerise do te jetë SKINTASTIC BEAUTY

#### NENI 4 KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Leke (Njeqind Leke) i përbeherë nga 2 (Dy) kuota.
2. I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortaket si ne vijim:

**Znj.** Leida Rakipaj, ka nënshkruar një kuotë me vlerë 50 Leke (Pesedhjete Leke) që përben 50% (pesedhjetepërqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

**Znj.** Migena Bego, ka nënshkruar një kuotë me vlerë 50 Leke (Pesedhjete mije Leke) që përben 50% (pesedhjetepërqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ortaket kane paguar vlerën e kapitalit themeltar.

3. Kuotat e kapitalit jane te transferueshme dhe mund të transferohen në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë statut dhe atyre të parashikuara nga ligji shqiptar.

#### NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Sherbime estetike, shplodhese, parukerie, qender (sallon) bukurie, SPA, trajtime estetike dhe dermatologjike, tregtim artikujsh kozmetike, suplemente ushqimore dhe artikuj te tjere qe kane lidhje me objektin e veprimtarise, veprmtari te tjera ne fushen e estetikes dhe dermatologjise estetike, vizita dhe trajtime mjeksore, si edhe import-eksport te produkteve estetike, suplemente ushqimore, kozmetike dhe parfumeri, ne perputhje me legjisacionin shqiptar. Kurse te formimit profesional

Te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi; te kryeje cdo aktivitet tjeter qe mund te konsiderohet i dobishem ose I domosdoshem per te arritur qellimin e aktivitetit te saj. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qe ben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshtet ate. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura.

#### NENI 6 KËRKESA PËR TË PAGUAR KUOTAT E KAPITALIT DHE TËRHEQJA E KUOTAVE TË PAPAGUARA

- (1) Administratori mund t'i kërkojnë ortakut të paguajë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tij dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën, katërmëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, si përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë

që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave, me të cilat lidhet thirrja për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote mbajnë përgjegjësi bashkërisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.

(3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e pashlyer në fund të afatit të vet, personi të cilit i drejtohet thirrja dhe i cili është përgjegjës për pagesën, paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati deri në momentin e pagimit me një normë vjetore interesit sipas Bankës se Shqipërisë.

(4) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japi një njoftim prej jo më pak se katërmëdhjetë ditësh të plota personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumular. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, përgjigjen duke u anuluar.

(5) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kerkuar nga njoftimi, mund të tërhiqet me vendim të asamblesë dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.

(6) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpérndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsideron të arsyeshme administratori.

(7) Personi prej të cilit janë tërhequr kuotat e kapitalit pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra, por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së kuotave në lidhje me këto kuota së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara tërheqjes.

## NENI 7 KUOTAT, TË DREJTAT DHE KUFIZIMET

Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tillë, siç përcaktohet në vendimin me shumicë të kualifikuar (me tri të katërtat e votave) të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Nenin 87 te Ligjit.

## NENI 8 CERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT

Çdo Ortak, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72 paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët, renditen në certifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

## NENI 9 KALIMI I KUOTAVE ME KONTRATË

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formalitetave të vendosura nga Asambleja e Përgjithshëm e Ortakëve. Kalimi i kuotës i njoftohet Shoqërisë në selinë e regjistruar. Administratori mund të mos pranojnë ta regjistrojnë kalimin e kuotës pranë Regjistrat Tregtar, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi ne përputhje me procedurën e parablerjes. Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, ai, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në Shoqëri, i dërgonë marrësit njoftimin për mospranimin.

### NENI 10 **KALIMI PËRMES TRASHËGIMISË OSE FALIMENTIT**

(1) Nëse një ortak vdes, bashkëzotërueshit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotëruesh i vetëm ose një bashkëzotëruesh i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët Shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij; Por, asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pronësi e ortakut te vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotërueshi i kuotës ose të kërkojë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesh vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos, që të kërkojë, që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjetër duke marre parasysh procedurën e parashikuar te parablerjes.

(3) Personi, që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, gjëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesh i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë Regjistrat Tregtar ai nuk gjëzon të drejtën e pjesëmarries ose të votës në Asamblenë e Përgjithshëm te Shoqërisë.

### NENI 11 **ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

(1) Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin, me vendim të marrë me shumice të thjeshte, Gjithashtu edhe rritja e kapitalit me qellim emetimi te kuotave te reja per shitje tek te tretet do te miratohet me shumice te thjeshte.

(2) Me anë të një vendimi me shumicë të thjeshte, Shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

### NENI 12 **MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

(1) Administratori mund të thërrasë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme sipas parashikimeve te Nenit 82 te Ligjit si dhe ne çdo rast kur ai e mendon të arsyeshme vetë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund te thirret edhe nga ndonjë nga ortaket sipas parashikimeve te nenit 84 ose çdo rasti tjetër te lejuar specifisht ne kete Statut..

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej Ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota pune përpara mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e

ortakëve që zoterojnë jo më pak se nëntëdhjetë përqind të kapitalit. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

(3) Kur Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve mblidhet jo ne përputhje me parashikimet e paragrafëve 1 dhe 2 te këtij nenit, vendime te rregullta mund te merren nëse të gjithë Ortaket që përbëjnë 100% (njëqind përqind) te kapitalit janë dakord që te merren vendime pavarësisht parregullsisë.

4) Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mund të marrë vendime të vlefshme me vote pro te tre te katërtave te ortakeve me te drejte vote per çështje ne lidhje me përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

### NENI 13

#### PUNIMET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Nenin 86 të Ligjit. Ortakët ose zotërueshit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratori cakton një Kryetar për të drejtar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

(3) Nëse Administratori nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes ose nëse nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, Ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtar mbledhjen si Kryetar i saj.

(4) Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndrysht, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.

(6) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë:

I.Kryetari; ose

II.një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

(7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një

shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8)Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

### NENI 14 VOTAT E ORTAKËVE

(1)Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.

(2)Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.

(3)Kundërshtimet e ngitura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Të gjitha votat e pa hequra në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë janë të vlefshme.

### NENI 15 HETIMET E POSACME

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë notieriale, e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

### NENI 16 EMËRIMI I ADMINISTRATORIT

(1)Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të caktuar, sipas parashikimeve të Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi me shumice te zakonshme i cili, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.

(2)Administratori i shoqërisë do te jete:

**Znj. Leida Rakipaj** e bija e Nendorit dhe Leonores, e datëlindjes 17/03/1984, lindur ne Fier, Shqipëri, dhe banuese në BLV “Bajram Curri”, Nd. 20, H. 5, Ap. 7, Njesia Administrative Nr. 3, 1019, Tirane, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Leternjoftimit me numër 035398465, lëshuar nga Ministria e Brendshme e Republikës se Shqipërisë më datë 19/12/2019.

e cila do te mbaje kete mandat per një afat 5 (pese) vjeçar duke filluar nga data e regjistrimit te Shoqërisë.

(3) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Nenin 95 paragafi (2) të Ligjit.

### NENI 17 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

- 1) Veprimitaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit. Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të kishin qenë te vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishin dhënë direktiva.
- (2) Administratori mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre apo te autorizojnë persona te tjerë për te ndërmarrë dhe kryer formalitete te zakonshme te aktivitetit shoqëror duke përfshirë por pa u kufizuar në deklarime dhe pagesa pranë autoriteteve shtetërore dhe shoqërive të utiliteteve (uje, energji elektrike, etj);

### NENI 18 LARGIMI I ADMINISTRATORIT

- (1) Posti i Administratorit lirohet nëse:
  1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit, përfshirë Nenin 95 paragafi 6.
  2. hyn në procedurën e paaftësisë paguese;
  3. vuan ose mund të vuajë nga çrrëgullime mendore;
  4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
  5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa leje në mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe ngae Asambleja e Përgjithshme.

### NENI 19 SHPËRBLIMI I PUNËS, PËRFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATORIT

- (1) Administratori ka të drejtë të marrin shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë ekzistuese, ose për familjare të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla (si përpara ashtu dhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).
- (3) Administratorit do ti paguhën të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera që u lindin në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme apo mbledhje të veçanta të zotëruarve të klasave të aksioneve të shoqërisë, si dhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre.

### NENI 20 DIVIDENTET

(1) Pas përbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividente me përputhje me të drejtat përkatëse të Ortakëve.

(2) Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjeshëtohen dhe paguhen në përpjeshëtëm me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend, duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.

(3) Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshmëri në lidhje me një kuotë, nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

(4) Nëse një dividend nuk është térhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të térhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anullohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

## **NENI 21** **KAPITALIZIMI I FITIMEVE**

Asambleja e Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, mund të vendosi të kapitalizojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë, që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferenciale ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

## **NENI 22** **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpëndarje e tillë midis ortakëve.

## **NENI 23** **NJOFTIMET**

(1) Njoftimet që i jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit, duhet të janë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik.

(2) Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me postë në një zarf, për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotëruar të një kuotë, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruarve në përputhje me Nenin 7, paragrafi (2) i Ligjit.

(3) Në këtë Statut përfshihen shtesa dhe ndryshime dhe të gjithë dokumentet e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë.

### **NENI 24**

Ky Statut përpilohet në 5(pese) kopje origjinale me vlerë të njëjtë ligjore në gjuhën shqipe. Statuti mbyllt me 25(njëzet e pese) nene.

Ky Statut do te shërbej gjithashtu si Akt i Themelimit te shoqërisë se re dhe do te regjistrohet ne Regjistrin Tregtar me depozitimin e këtij dokumenti te nënshkruar.

### **NENI 25**

Ngarkohet **Znj. Leida Rakipaj** e bija e Nendorit dhe Leonores, e datëlindjes 17/03/1984, lindur ne Fier, Shqipëri, dhe banuese në BLV "Bajram Curri", Nd. 20, H. 5, Ap. 7, Njesia Administrative Nr. 3, 1019, Tirane, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Leternjoftimit me numër 035398465, lëshuar nga Ministria e Brendshme e Republikës se Shqipërisë më datë 19/12/2019, per ndjekjen e procedurave ligjore per Regjistrimin e shoqerise prane Qendres Kombetare te Bisnesit.

### **ORTAKET E SHOQERISE**

**LEIDA RAKIPAJ**



**MIGENA BEGO**

